



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 160, datë 30.11.2017

**PËR REVOKIMIN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË SI
VLERËSUES DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 226 e vijues, të Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” licencon vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Z. Ilia Mazniku është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve shëndetësore sipas licencës nr. 98, datë 25.06.2014.

Në zbatim të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, formati i raportimit (Formulari A), është i detyrueshëm për t’u plotësuar dhe depozituar në Autoritet nga vlerësuesit e pavarur dhe AMF ka kërkuar depozitimin e saj brenda datës 30 korrik 2017.

Sipas këtij formati, Autoriteti monitoron kërkesat e ligjit që lidhen me disponimin e policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale të vlerësuesit të dëmeve, referuar nenit 229, të Ligjit 52/2014, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij brenda 6-muajve nga data e marrjes së licencës, referuar nenit 228, të këtij ligji.

Z. Ilia Mazniku nuk ka depozituar formularin e kërkuar.

Në këto kushte, Autoriteti ka dërguar shkresën nr. 2659 prot., datë 25.09.2017, ku njofton se ka filluar procesin e revokimit të licencës së ushtrimit të veprimtarisë si vlerësues i dëmeve në sigurime, duke kërkuar paraqitjen në Autoritet për t'u dëgjuar dhe nuk është paraqitur.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i revokohet licenca nr. 98, datë 25.06.2014, z. Ilia Mazniku, për të ushtruar veprimtarinë si vlerësues dëmsh në sigurime.
2. Licenca nr. 98, datë 25.06.2014, duhet të depozitohet në Autoritet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI